**LIGJ**
**Nr.10 131, datë 11.5.2009**

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9975, DATË 28.7.2008 "PËR TAKSAT KOMBËTARE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3 "Llojet e taksave kombëtare", pika 6 ndryshohet si më poshtë:

"6. Taksa për ushtrim veprimtarie në fushën e lojërave të fatit për baste sportive, baste për gara në pistë, për kazino, për kazino elektronike, për lotari kombëtare, për bingo tradicionale dhe për bingo televizive.".

Neni 2

Në nenin 4 "Niveli i taksave kombëtare", pika 6 ndryshohet si më poshtë:

"6. Taksa për ushtrim veprimtarie në fushën e lojërave të fatit për baste sportive, baste për gara në pistë, për kazino, për kazino elektronike, për lotari kombëtare, për bingo tradicionale dhe për bingo televizive caktohet:

a) Për ushtrim veprimtarie (për shoqërinë)

| | | |
|---|---|---|
| - për baste sportive | 2 000 000 | lekë/vit; |
| - për baste për garat në pistë | 2 000 000 | lekë/vit; |
| - për kazino elektronike | 1 000 000 | lekë/vit; |
| - për bingo tradicionale | 2 000 000 | lekë/vit; |
| - për bingo televizive | 2 000 000 | lekë/vit; |

b) Për marrjen e licencës

| | | |
|---|---|---|
| - për lotari kombëtare | 300 000 000 | lekë; |
| - Për kazino: | | |
| - për Tiranën | 1 000 000 000 | lekë; |
| - në zonat turistike | 300 000 000 | lekë. |

Taksa për ushtrim veprimtarie në fushën e lojërave të fatit për baste sportive, baste për gara në pistë, për kazino elektronike, për bingo tradicionale dhe për bingo televizive paguhen pranë organit tatimor, ku është regjistruar subjekti juridik, në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin nr.10 033, datë 11.12.2008 "Për lojërat e fatit"".

Neni 3

Në nenin 5 "Agjentët e taksave", shkronja "dh" ndryshohet si më poshtë:

"dh) për taksat për ushtrim veprimtarie në fushën e lojërave të fatit për baste sportive, baste për gara në pistë, për kazino, për kazino elektronike, për lotari kombëtare, për bingo tradicionale dhe për bingo televizive, struktura përgjegjëse e lojërave të fatit në ministrinë

përgjegjëse për financat”.

Neni 4

Në nenin 8 “Komisionet, që përfitojnë agjentët e taksave”, shkronja “dh” ndryshohet si më poshtë:

“dh) taksa për ushtrim veprimtarie në fushën e lojërave të fatit për baste sportive, baste për gara në pistë, për kazino, për kazino elektronike, për lotari kombëtare, për bingo tradicionale dhe për bingo televizive, zero për qind”.

Neni 5

Në shtojcën nr.3 të ligjit, pika 5 “Për regjistrimin e lënies së shtetësisë” shfuqizohet.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6182, datë 25.5.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**